



Npi – 01/167 datë: 31.05.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.05.2022 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 31.05.2022, (e martë) në ora 9.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Perparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Asllan Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiki, Heroina Selmani, Kadri Emini, Rrezartë Ramadani, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, z.Bujar Ferati, nga ZKF-ja ; z.Lulzim Muharremi, nga Zyra Ligjore; z.Reshat Gashi, nga zyra për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; z.Gazmend Ademaj, dhe Shpëtim Gashi nga Zyra për Informim; z.Muhamet Hoxha, nga Radio Zëri i Shtimes; z.Mefail Mustafa, nga OSBE; TV-“Spin” Shtime; znj.Valmira Hoxha, praktikante; Si dhe dia qytetarë të interesuar.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 29.04.2022,
2. Pyetje Përgjigje,
3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025,
4. Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022,
5. Propozim-Vendim për rritjen e Buxhetit të vitit 2021 për realizimin e të hyrave Vetanake,
6. Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MBPZHR,Nr.1556/3 dt.29.04.2022,
7. Propozim-Vendim për ndarjen e 100 € për Nënata Lehona për çdo fëmijë të lindur në 2022,
8. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm pronat e paluajtshme në Zk-Shtime dhe ZK-Petroviq, për Projektin “Unaza e Vogël e Shtimes”,
9. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-56 për rizgjedhjen e Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport , sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-4-2022, dt.13.04.2022,

10. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-57 për rizgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-3-2022, dt. 13.04.2022,

11. Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026, (Pas diskutimit publik)

12. Informatë nga Sektori i Bujqësisë për mbjelljet Pranverore,

13. Informatë e përgjithshme nga DKRS-ë,

14. Shqyrtimi i Kërkesave Npi-01/113 – Pikë Shtesë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, duke e përfshi edhe pikën 14 Shtesë të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit “ Shqyrtimi i Listës së Kërkesave Npi-01/113” mirëpo unë jam i mendimit që ti debatojmë të gjitha pikat, e jo ta kursejmë kohën.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, ne si koalicion LDK-AKR e përkrahim rendin e ditës, por kërkojmë që në mbledhjen e radhës të futet si pikë e rendit të ditës edhe qështja e Çerdhes në fshatin Petrovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi rendin e ditës me pikën 14 shtesë Kuvendit “ Shqyrtimi i Listës së Kërkesave Npi-01/113”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 29.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; I kam dy vërejtje, kam thënë se ndjem krenar në kohën e qeverisjes në kohën e z.Fehmi Mujotës kur ka qenë ministër sepse i ka shtruar të gjitha rrugët me përjashtim fshatin xxxxxxx

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 votë “Abstenim” aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit më 29.04.2022, me vërejtjet.**

Pika 2

Pyetje Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Në mbledhjen e kaluar nuk kam marrë sqarim të duhur nga DKA prandaj po e përsëris pyetjen për DKA-në pse një Çerdhe për fëmijë është mbyllur, e ndërkohë na vjen një kërkesë për një Çerdhe të re? (Përsëritje e pyetjes).

z.Muhamet Ademaj; Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DKA-në shkollën profesionale është ndërtuar një serrë a jeni në dijeni për këtë dhe në qoftëse po, pse ende kjo serrë nuk është funksionale? 2. Pyetje për DSHP-në lagjen Ademaj është ndarë një parcelë për varreza, ndërkaq aty tani po ndërtohet një fushë sportive si ka mundësi kjo?

znj.Albana Podvorica; Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DKRS-në në shtëpinë e kulturës po mbahen aktivitete a mundë të na tregoni se kush po i organizon ato aktivitete që po mbahen? 2. Pyetje për DKRS-në cili është plani i juaj për ta aktivizuar rininë?

znj.Adelina Beqaj; Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DKA-në, sipas Udhëzimit Administrativ te procedurat e përzgjedhjes, konkursi duhet të shpallet menjëher pas 5 dite, pse ju nuk e keni shpallë konkursin, kur Kryetari ka premtuar depolitizim. 2. Pyetje për DSHP-në rrugën “Anton Qeta” po qarkullojnë automjete të rënda, edhe pse është i ndaluar qarkullimi i automjeteve të rënda në këtë rrugë, kush po i jep këto leje për qarkullim?

3. Pyetje për Kryesuesin e Kuvendit, pse nuk na e keni sjellë listën e pronave të fshatit Petrovë, kur ne e kemi përkrahë këtë Çerdhe?

z.Besnik Seferi: Kamionat me pesha të rënda në rrugën “Anton Çeta” kanë lëvizur edhe më përpara. Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DKRS-në, si është gjendja e bibliotekës në Shtime, dhe sa është numri i lexuesëve në bibliotekë? 2. Pyetje për DKRS-në a mundë të na informoni për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, dhe a kanë sjellur raport për punën e tyre? 3. Pyetje për DKRS-në duta të di nga drejtorja se sa janë subvencionuar klubet sportive? 4. Pyetje për DPUKGJ-në, 10 shtëpi kanë problem me Kanalizimin në fshatin Reqak “ruga 15 janari, kur do të rregullohet kanalizimi aty? 5. Pyetje për DKA-në a janë shpallë orët për një mësimdhënës i cili nuk është mire me shëndet në drejtimin Histori nëse po a do të shpallni konkurse të reja së shpejti?

znj.Besartë Musliu-Spahija: Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DSHP-në pse nuk është duke funksionuar ndriqimi publik në pjesën të parku i pishave, si dhe mirëmbajtja e hapsirave në park?

2. Pyetje për DPUKGJ-në në lidhje me problemin me kanalizim të lagja e pishave kur do të rregullohet?

z.Rexhep Gashi: Përgjigjet nuk i kemi marrë të plota, prandaj po e përsëris prapë të njejtën pyetje për DKA-në a është pranuar teknikisht paralelja e ndarë e shkollës fillore “Lasgush Poradeci” në Gjyrkovc dhe pse nuk është funksionale? 2. P yetje për DPUKGJ-në te kryqëzimet po mungojnë disa pasqyra të këndit të vdekur ende nuk janë vendosur, kurë do të vendosen ? 3. Pyetje për DPUKGJ-në ndriqimi publik nuk është funksional, në këto shtylla elektrike janë disa panele diellore a janë funksionale këto dhe pse nuk shihet që janë funksionale?

z.Lumni Amrushi: Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DPUKGJ-në për projektet dy vjeqare që kanë qenë të paraparë për vitin e kaluar por që duhet të vazhdojnë në fshatin Pjetershticë kur do ti filloni punimet e atyre kontratave?

z.Adem Ramadani: Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për Kryetarin deshta ta di se qysh është puna e shtabit në Rancë, a do të fillon puna për rregullimin e rrugës deri te shtabi, dhe a do të asfallohet?

z.Përparim Ramusa: Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për DKRS-në në inforamtën që na kanë dërgu në sektorin e kulturës për data të veqanta ka potencu që 14 shkurt 2022 është përvjetori i pavarësisë, kjo date nuk është por 17 Shkurt është dita e pavarësisë, kështu që mos na i ndërroni datat?

2. Pyetja për DKRS-në në material të Kuvendit na ka ardhë një informatë me datën 22, ku drejtoresha në informatë ka deklaruar se klubi futbollistik “Vjosa” është bërë kampion që nuk është e vërtet klubi futbollistik “Vjosa” është bërë kampion me datën 30 në gjiron e fundit që ka pas ky. Kërkojë një sqarim?

z.Hamëz Tërshani: Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për Kryetarin në lidhje me lokacionin për Çerdhen në Petrovë, në këtë mbledhje nuk na ka ardhë asgjë si propozim, qka ka ndodhë me lokacionin e Çerdhes?

2. Pyetje për DSHP-në në lidhje me gjendjen aktuale të mbeturinave a është marrë drejtorja me këtë, si dhe gjendja e lumit është e tmerrshme a mundeni me na njoftu për masat që janë duke u marrë për këtë?

z.Rrahman Jakupi: Kamë këto pyetje, 1. Pyetje për Administratë, kërkoj një informatë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare dhe përgjigjeve të dhëna?

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përshëndetje, faleminderit për pyetje, sa i përket pyetjes së Ademit, ne e kemi vizituar vendin e pikës të shtabit në Rancë, dhe kemi vendosur bashkarishtë me z.Zogaj përfaqësues i agjencionit, se do të fillojmë projektin dhe ne do të ju ofrojmë gjithë ndihmën tonë , ne po bëjmë përpjekje që ky projekt të fillojë sa më parë. Sa i përket rrugës për fshatin Rancë ka qenë i paraparë një fond i vogël, mirpo ne e kemi rritë në 50 mijë euro, unë besojë se projekti do të fillojë shpejtë. Sa i përket lokacionit për Çerdhe në fshatin Petrovë, Kryetari i fshatit ka kërkuar nga ne më shumë kohë për ti rregulluar paqartësit lidhur me caktimin e loacionit për Çerdhe.

Në momentin që do të jenë të përfunduara paqartësit dhe ta kemi një lokacion të përshtatshëm për Çerdhe ne do ta sjellim në Kuvend për aprovim.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, sa i përket projekteve në fshatin Pjetershticë, ne i kemi gjetë dy projekte dy vjeqare, puna e të cilave do të fillojë shumë shpejt. Sa i përket vendosjes së shenjave të komunikacionit, konkretisht pasqyreve që i përmendi z.Rexhep Gashi, është mirë që ta

kemi propozimin ose kërkesën në formë të shkruar. Sa i përket pyetjes për kanalizimin vërtetë është problem për ta rregulluar në formë parciale. Po ashtu edhe te pishat është problem për me rregulluar sepse është në pronë private. Ndërsa kanalizimi në rrugën “15 Janari” do të përfundojë këtë vitë.

z.Rexhep Gashi; Sa i përket vendosjes së pasqyrave, në këndet e vdekura unë i kam përmendur rrugët “12 Qershori” dhe “Jetë Hasani”.

znj.Adelina Beqaj; Po më vjen mirë që keni arritur ta realizoni buxhetin sepse mjete ka.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë ju lus edhe një herë që pyetjet ti bëni me shkrim, edhe për shkak të kursimit të kohës edhe për shkak të faktit se pyetjet janë më të sakta.

Pika 3

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë e lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë; Përshëndetje, sot para jush po e prezantojmë, KAB-in për periudhën 2023-2025. Ky është dokument strategjik për Komunën tonë i cili i paraprin aprovimit të buxhetit të Komunës. Siq e dini KAB-in e aprovojme për gjdo vitë. Në vazhdim do të lexojë vetëm propozimet në vija të trasha sepse ky dokument duhet të shkojë në debat publik. Unë besojë se e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj nuk do ta zgjati shumë mirëpo nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Reshat Mujota; Në KAB-in e vitit të kaluar në krahsim me këtë vitë unë nuk i kam parë disa ndryshime të cilat i kemi kërkuar edhe më herët, siq janë specifikimi i projekteve me emërtimin e saktë të rrugëve, edhe pse Kryetari ka thënë se të gjitha projektet kanë me qenë të specifikuara. Te Mollopolci unë kam pritur që do të ketë specifikim të saktë të projekteve. Për 4 vite janë paraparë 124 mijë euro. Pse në fshatin Mollopolc nuk ka ndriqim sikurse në disa fshatra tjera.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë; Realisht unë po i arsyetojë pak drejtoritë për planifikimin e KAB-it sepse materiali na ka ardhur me vonesë dhe nuk kanë pasë kohë të mjaftueshme për planifikim e KAB-it, mirëpo meqenëse do të shkojë në debat publik kemi mundësi të mira për ta përmirsuar.

z.Përparim Ramusa; Ne kemi diskutuar edhe në KPF dhe kemi rekomanduar që të shkojmë edhe ne diskutim publik, kështu që drejtori ka kohë dhe mundësi për me i përmirsuar shumë gjëra. Ne do ta përkrahim vendimin për diskutim publik.

z.Rexhep Gashi; E falenderojmë ZKF-në për sqarimet lidhur me KAB-in kështu që edhe ne do ta përkrahim vendimin që të shkojmë në debat publik.

z.Muhamet Ademaj; Edhe ne e falenderojmë ZKF-në për sqarimet, meqenëse jemi mir me kohë për ta qar në debat publik i ftojme të gjithë qytetarët që të marrin pjesë në debat dhe të japin kontributin e tyre.

z.Besnik Seferi; Meqenëse KAB-i është dokument i rëndësishëm për Komunën tonë, i cili duhet të shkojë ne diskutim publik, edhe ne i bëjmë ftesë qytetarëve që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë me propozime. Më vjen mirë që ZKF-ja tani paska pasur mundësi për me i specifikuar disa projekte, sepse para 4 vitëve thoshin se nuk kanë mundësi për me i specifikuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitë miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën afatmesme buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2023-2025, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra Komunale e Financave, Komiteti për Politikë dhe Financa, si dhe Zyra për Informim.**

Pika 4

Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë e lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë; Propozim-Vendimin për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022, e keni pranuar me kohë, unë do të lexojë të dhënat nga ky dokument, që besoj se e keni lexuar. (Shih dokumentin) Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Përparim Ramusa; Ashtu siç jemi dakorduar në KPF-ë, ne e mbështesim dhe pajtohemi që ta miratojmë, ashtu siç është propozuar.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, ne si grup parlamentar i LDK-AKR-së e përkrahim dhe do ta votojmë, Propozim-Vendimin për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022, ashtu siç janë planifikuar nga ZKF-ja.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022, sipas rekomandimit të KPF-së.**

Pika 5

Propozim-Vendim për rritjen e Buxhetit të vitit 2021 për realizimin e të hyrave Vetanake

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë e lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë; Edhe për këtë pikë materialin e keni marrë me kohë, unë do ti lexojë të dhënat nga ky dokument, (Shih dokumentin) Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Përparim Ramusa; Sipas rekomandimit të KPF-ë, ne e mbështesim dhe pajtohemi që ta votojmë. I falënderojmë qytetarët për kryerjen e obligimeve të tyre tatimore.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ju falënderoj për përkrahje të kësaj pike, do të bëj dy njoftime për qytetarët, e para i falënderoj të gjithë qytetarët e komunës tonë që u janë përgjigjur pagesave tatimore, për arsye se kanë treguar edhe besimin që kanë ndaj qeverisjes komunale. Të hyrat komunale janë rritur për 47 mijë euro më shumë. Kështu që edhe subvencionet i kemi rritë si në Bujqësi janë shumëfishuar, pastaj në Arsim, kulturë rini e sport. Me raportin financiar do të bëjmë publike të gjitha rritjet buxhetore që i kemi bërë për këtë vit.

z.Muhamet Ademaj; I falënderojmë të gjithë qytetarët e Komunës tonë që u janë përgjigjur pagesës së tatimit.

z.Përparim Ramusa; Rritja ka ndodhë në vitin 2021 kur ka qenë PDK-ja në qeverisje.

z.Reshat Mujota; Mirë është me ditë për zyrtarët dhe drejtorët e administratës komunale se a i kan paguar tatimet që i kanë për obligim. Unë po kërkojë një listë me emrat e zyrtarëve për me na e sjellë në Kuvend.

z.Besnik Seferi; Edhe unë i falënderoj qytetarët për pagesën e obligimeve tatimore, mendojë se nuk është me rëndësi a është kjo në 2021 a është në 2022. Sa i përket dyfishimit të subvencioneve për bursa të studenteve unë po dua që ta përgëzojë për këtë gjest shumë të mirë.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë; Po bëhet fjalë për rritjen e të hyrave, trendi i të hyrave na tregon se kohët e fundit gjithënjë po vjen duke u rritur sivjet është rritur për 12%.

znj.Adelina Beqaj; Kryetari po don me bërë të qartë rritjen, mirëpo ne për gjdo vitë presim rritjen e të hyrave, meq' rast i falënderojmë të gjithë qytetarët.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Rritjen e besimit unë e permenda duke pas parasysh periudhën 5 mujore të qeverisjes tonë, e për të cilën qytetarët duhet falënderuar jo vetëm për këtë periudhë po për të gjithë kohën që ata janë të përkushtuar ti paguajnë obligimet tatimore. Mirëpo këto do tu kthehen në interes të tyre siq e thashë me rritjen e subvencioneve.

z.Rrahman Jakupi; I falënderoj qytetarët por edhe z.Bujar Feratin, duke e ditur se dy vitet paraprake kemi qenë në pandemi. Rritja e të hyrave është njëkohësisht edhe meritë e bashkëatdhetarëve tanë, të cilët i falënderojmë.

z.Rexhep Gashi; I falënderojmë qytetarët që u janë përgjigjur pagesës së kontributeve. Unë mendojë se nuk ka nevojë që të falënderohet ekzekutivi sepse aj e ka për detyrë dhe paguhet për me e kryer

punën e vet. Dy vite kemi pas pandemi është e vërtet por më herët herë kemi pasë pak ngritje e herë ramje. Është për ti falenderu qytetarët që kësaj here kemi një rritje të mirë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. ***Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 31.05.2022, unanimitisht miratoi Vendimin për ndarjen e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2021, në vitin 2022, në shumën prej 307,384.53 euro.**

Pika 6

Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MBPZHR, Nr.1556/3 dt.29.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë, dhe lexoi rekomandimin e KPF-së.

z.Përparim Ramusa; Ashtu siç u dakorduar në KPF-ë ku kemi vendosur ta kalojmë, mirëpo kemi kërkuar që propozimet e tilla nuk duhet të na vijnë pas kohe, sepse një ndryshim të rregullorës e kemi bërë edhe muajin e kaluar.

z.Reshat Mujota: Kur na vjen një rekomandim i tillë nga ministria patjetër që duhet me aprovuar, kështu që neve na mbetet ta miratojmë.

z.Kadri Emini; Normal që Ministria e Bujqësisë e mbulon fushën e Bujqësisë sigurisht që ne duhet ta përkrahim. E udhës është që propozimet nga Ministria për ndryshimin e rregullorës me na ardhë bashkërishtë, e jo të ndara dhe kohë pas kohe. Ne si LDK-AKR i mbështesim këto ndryshime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022, Npi – 01/70 datë: 07.04.2022, sipas kërkesës të MBPZHR, Nr.1556/3 të datës: 29.04.2022.**

Pika 7

Propozim-Vendim për ndarjen e 100 € për Nënën Lehonë për çdo fëmijë të lindur në 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë, dhe lexoi rekomandimin e KPF-së.

z.Besnik Seferi; Më vjen mirë që më në fund propozimi ynë u realizua, që dy vite që e kemi inicuar ne si Lëvizje Vetëvendosje për nënat lehonë që ti marrin nga 100€ për ç'do lindje të fëmijut. I uroj të gjitha nënat, dhe besojë se të gjithë do ta përkrahin këtë vendim.

z.Përparim Ramusa: Është e vërtet se këtë vendim e kemi aprovuar vitin e kaluar, dhe këto mjete ndahen prej taksave të qytetarëve.

z.Lumni Amrushi: Propozojë që kjo shumë të dyfishohet.

znj.Rrezartë Ramadani: Edhe ne e përkrahim këtë ndihmë për nënat lehonë, kështu që ju përgëzojë për këtë vendim. Ne do ta përkrahim.

z.Reshat Mujota: Ju përgëzojë për këtë vendim që e keni marrë në vitin e kaluar, sepse do ta shtojnë natalitetin.

z.Rexhep Gashi; Vendimi është marrë në 2021. I falenderojë të gjithë asambleistët për këtë vendim.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Jam i lumtur që më në fund po diskutojmë për këtë pikë, besojë se do ta përkrahin të gjithë anëtarët e kuvendit. Është e vërtet se është miratuar në buxhet në vitin e kaluar si subvencione por nuk kemi një vendim konkret të Kuvendit. Ne e kemi shtuar shumën e subvencioneve për këtë destinim edhe për 5 mijë euro me qëllim që të kemi mjete financiare të mjaftueshme.

z.Kadri Emini: Sa i përket ligjshmërisë të vendimit mendojë se duhet të ceket në vendim se ka prapaveprim, dmth. Për të gjithë fëmijët e lindur nga 1 janari 2022.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2022, e mbajtur më 31.05.2021, unanimitisht miratoi Vendimin për ndarjen nga 100€ (njëqind euro) për secilën Nënë-Lehonë, për ç'do fëmijë të lindur në vitin 2022, për banorët e Komunës së Shtimes.**

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm pronat e paluajtshme në Zk-Shtime dhe ZK-Petroviq, për Projektin "Unaza e Vogël e Shtimes"

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të ja jap fjalën drejtorit Grejtalb Eminit për prezantimin e kësaj pike, po sqaroj se KPF-ja nuk ka pas rekomandim për këtë pikë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, ne si qeveri komunale e kemi premtuar ndërtimin e "Unazës së vogël të qytetit". Projekti kushton rreth 380 mijë euro, ka rreth 960 metra. Ndërsa për shpronësim i kemi 1.86 hektar. Bazën Ligjore e e kemi në dokument, kështu që unë ju propozoj që ta miratoni këtë vendim.

z.Reshat Mujota; Faleminderit drejtorit për sqarimet, mirëpo unë po kërkoj një sqarim më të detajuar, sepse këtu po i prekim pronat private. E para duhet me sqaruar se kush e paguan këtë projekt. Unë nuk e kam të kuptueshëm projektin, sa prona duhet të shpronësohen, ky problem do të rritet ende sepse kemi edhe prona të tjera të pa shpronësuar. Le të zotohet Kryetari se unë i paguaj mjetet unë do ta votoj. Unë mendoj se kjo pikë duhet me u shty, kërkoj falje që nuk kam marrë pjesë në debat publik.

z.Përparim Ramusa; Projekti si projekt është i vlerësuar, mirëpo ka mangësi sepse nuk është e definuar se kushë ka me e shpronësuar. Unë kisha propozuar që me u shty sepse në këtë format nuk jam që të mbetet barrë e Kuvendit të Komunës.

z.Kadri Emini; Si projekt është i mirëpritur, qështja e kompensimit është diskutabile. Pronarët kanë me u kompensuar. Është një Komision i Ministrisë së Financave që e bënë vlerësimin e pronave që duhet të shpronësohen. Unë nuk po e shoh të Arsyeshme që të shtyhet, kështu që ne jemi që të miratohet.

z.Hamëz Tërshani; Debatit që na është ofruar ka mangësi të theksuara, unë jam jurist dhe mendoj se para se të miratohet, duhet me u bërë një studim të fizibilitetit për këtë projekt. Për këtë arsye unë mendoj se duhet me u shty kjo pikë, por edhe për faktin se unë nuk jam adhures i faktit që vendimi me na u kthyer nga Ministria. Po flasim për një rrugë prej 1 kilometri me 14 metra gjerësi. Unë pajtohem me një zotim të Kryetarit siq e tha edhe Reshati. Sot është i pa mjaftueshëm, kështu që unë nuk jam pro që Komuna me hy në obligime. Kështu pra unë propozoj që kjo pikë me u shty me qëllim që me u arsyetuar të gjitha gjërat.

z.Reshat Mujota; Unë kam një përvojë me shpronësimet, i di procedurat mirë se sa puna del, sepse mund të ketë edhe padi gjyqësore, kështu që mund të bllokohet projekti nga gjykata. Siç e dini ne i kemi të pa shpronësuar ende pronat te pusët e ujësjellësit. Unë jam i mendimit që fillimisht le të shterret debati, sepse nuk duhet të dëmtohet pronari i tokës private. Unë jam për me kalu por jo në këtë mënyrë, kështu pra në këtë mënyrë unë e kam votën "Kundër".

z.Muhamet Ademaj; Unë e përkrahu këtë projekt, sepse para së gjithash është në interes të qytetarëve.

z.Besnik Seferi; Sa i përket këtijë projekti është zotim i qeverisjes sonë. Mendoj se duhet të diskutohet. Nashta është dashtë me pasë një paramasë se sa do të kushtojë. Është mundësia që ndonjë pronari të tokës me i mbetë 4-5 metra sipërfaqe të pa shfrytëzuara, prandaj pse jo të analizohet më mirë. Këtijë projekti duhet ti gëzohet ç' do qytetarë sepse Shtimja po merr një pamje krejtësisht tjetër.

z.Lumni Amrushi; Ne e kemi pa një vijë se kah ka me ra kjo unazë. Unë kam një pyetje për drejtorin, meqenëse u përmend nga Kadrija një shumë-jo e madhe e mjeteve financiare për shpronësimet, sa mjete janë planifikuar për shpronësime? Dhe tjetër sa e di në këtë zonë kalon edhe tensioni i lartë i energjisë elektrike a ka pengesa për këtë gjë me ato prona, thjeshtë po pyes që dëmi mos të jetë shumë i madh.

z.Kadri Emini; Përafërsisht secili prej nesh e dimë se sa shkon (shitet) toka këtu te ne rreth rreth rrugës që sillet rreth 10 -15 mijë euro ari, dhe tani e dimë edhe sipërfaqen që duhet të shpronësohet, mirëpo unë thash se është Komisioni i posqam i Ministrisë së Financave që e del e bënë vlerësimin. Pastaj është qështje tjetër nëse pronarët pajtohen me vlerësimin e Komisionit, për këtë arsye i kanë edhe Gjykatat. Për ne është e rëndësishme garancioni për tu kompensuar ç' do pronarë i tokës. Tani nuk do të ndodhë më që një pronë të merret (blihet) me 1 euro për ari, e pastaj të shpronësohet me qindra-mijëra euro, siq ka ndodhur në të kaluarën.

z.Reshat Mujota; Pse me ja pru punën pronarit të tokës që ai me u detyru me e kërkuar të drejtën e vet nëpër Gjykata, unë po kërkoj që ti shterrim të gjitha mundësitë, dhe pastaj edhe unë kamë me e dhënë votën.

z.Rrahman Jakupi; Mendoj se metodologjia është e gabuar për sa i përket kësaj pike. Kjo unazë e lidhë fshatin Davidovc me Lagjën e Pajtimit, nuk është premtuar kjo në fushatë. Unë pajtohem që kjo të shtyhet. Disa projekte janë mbetur në gjysëm, duhet me i vazhduar. Shikone mundësinë për me e ndryshuar terminologjinë sepse unazë nuk shkon. Ne jemi për me hapë rrugë por jo në këtë mënyrë.

znj.Adelina Beqaj; Unë kamë qenë pjesëmarrëse gjatë diskutimit publik që është bërë, disa nga pronarët e tokave i pengon, sepse po dëmtohet prona e tyre, kështu që edhe nëse shtyhet prap gjendja te pronarët e tokave nuk ndryshon. Unë kërkoj garanci nga Kryetari se ka me e shpronësu ç'do milimetër të atyre pronave. Unë thjesht po kërkoj që me na sqaruar se qka kemi me votuar.

z.Rexhep Gashi; Ç'do projekt që bëhet është për ta përshëndetur. Kemi një shembull nga qeverisja e kaluar ku e kemi dëmtuar buxhetin rreth 360 mijë euro, e dimë se si e kemi kaluar atë vendim. Ne do ta ngrisim dorën nëse e dimë se kush do ta shpronësojë. Unë mendoj se duhet të analizohen mirë secila parcelë se kush realisht e gëzonë atë, sepse ne nuk duam që ta dëmtojmë asnjë pronarë të tokës ashtu siç i kemi dëmtuar qe disa vite me radhë me shpronësime të panevojshme. Unë po kërkoj që elaborimi të bëhet pak më konkret.

znj.Rrezartë Ramadani; Ky projekt është i emërtuar si “Unazë e brendshme e qytetit” dhe si i tillë do të mbetet. Projekti i tërsishëm është rreth 3 kilometra, por rreth një kilometër është që nevojitet të shpronësohet, drejtoria i ka paraqitur edhe pronarët edhe sasinë e pronave që duhet të shpronësohen. Ky projekt do të bëhet nga Ministria, nëse nuk e bënë Ministria atëherë do ta bëjë Komuna, sepse kemi Buxhet mbi 1.5 milion euro.

z.Rexhep Gashi; Unë dua të them se jam kundër këtijë elaborimi, do ta përkrahi nëse kemi një sqarim.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Faleminderit për pyetjet dhe komentet e juaja. Unë ju kisha lutë që ta përkrahni si një projekt kapital, para së gjithash që është në interes të qytetarëve, por edhe për sa i përket realizimit të planit urbanistik të Komunës së Shtimes. Është elaboruar gjërë e gjatë në procesin e diskutimit publik me qytetarë, dikush ka marrë pjesë e dikush nuk ka pas mundësi, mirëpo ne jemi duke e respektuar në plotëni infratrakturën ligjore. Në bazë të ligjit ne po marrim vendim si Kuvend që pronat që preken me këtë projekt ti shpallim prona me interes të përgjithshëm ashtu siq e kërkon Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr.03-L-139. Më pastaj në procedurën e shpronësimit Deopartamenti i Pronave në Ministri do të analizoje dhe vlerësoje ç'do milimetër të pronave dhe do të dalë me një vendim për vlerësimin e këtyre pronave. Më pastaj është edhe procedura Gjyqësore për ata që nuk janë të kënaqur me vlerësim. Ju njoftoj juve, qytetarët dhe pronarët e këtyre tokave se në vitin 2023 kemi mbi një milion euro buxhet më shumë, sidoqoftë ne kemi diskutuar me Ministrinë, dhe kemi kërkuar që ta kemi një kod të veçantë buxhetor, ku vetë do të mund ta bartim koston e këtijë projekti. Mirëpo ne jemi të lumtur që Ministria vetë e ka marrë përsipër shpronësimin e këtyre tokave cent për cent. Unë zotohem se, edhe nëse askush nuk merr për obligim kompensimin e pronarëve të tokave për këtë projekt, unë si Kryetarë i Komunës së Shtimes, në fund të këtijë projekti dy vjeçarë do ti paguaj pronarët cent për cent. Sasia e tokës që duhet të shëpronësohet për projektin “Unaza e vogël e qytetit” është rreth 1 hektarë e 80 ari. Për ne ky projekt ka rëndësi të veçantë, sepse u kemi premtuar banorëve të komunës tonë se do ta realizojmë një projekt të tillë. Edhe banorët në diskutim publikë janë treguar shumë entuziastë dhe e kanë mirëpritur sepse po u lehtësohet qarkullimi i njerëzve dhe mallrave më lehtë dhe më shpejtë. Unë mendoj se shtyrja e miratimit të kësaj pike nuk do të na ndihmojë më shumë, përkundrazi do të humbim kohën e qmuar të verës për sa i përket realizimit të këtijë projekti. Unë ju garantoj se realizimi i këtijë projekti do të jetë një proces tërsisht transparent, prandaj ju ftoj që të gjithë bashkërisht ta miratoni.

z.Përparim Ramusa; Diskutimi i Kryetarit, mu duk konfuz, sepse foli për zotimin e Ministrisë, ndërsa zotimin e dytë e bëri në emër të Komunës. Dihet që për me aprovu Komuna duhet me aprovu Kuvendi.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Unë po dua me qenë decidiv dhe i çartë, ashtu qysh e thashë edhe më parë se ashtu qyshë kamë arritë për me gjetë mirëkuptim për këtë projekt në Ministri, ashtu pra thash se në

fund të fundit nëse për far do arsye nuk kryhet ky shpronësim, unë si Kryetarë i Komunës së Shtimes e marrë përsipër pagesën e shpenzimeve për pronarët e këtyre tokave që duhet të shpronësohen, cent për cent.

znj. Adelina Beqaj; Lutjet tua për me aprovuar mund ti pranojmë vetëm me dokumentacion shtesë. Unë po kërkoj një sqarim shtesë se çka do të ndodhë me pjesën tjetër?

Kryetari, z. Qemajl Aliu; Ky projekt do të realizohet në bazë të kriterëve dhe Ligjeve të Republikës së Kosovës, ky vendim nuk është i pari që po merr Kuvendi i Komunës së Shtimes, vendime të tilla për shpalljen e pronave private me interes të përgjithshëm do të merr edhe në të ardhmen që janë në interes të qytetarëve.

z. Hamëz Tërshani; Më bëri përshtypje diskutimi i anëtarit të LDK-së, krejt çka ne po kërkojmë është më shumë sqarime. Është parim se ai që e merr vendimin edhe paguan. Unë e kuptoj përkushtimin e Kryetarit, mirëpo unë mendoj se ka nevojë me u bërë një studim i fizibilitetit. Neve na duhen informata shtesë. Ne nuk jemi kundër por procedura është e ngutshme, le të respektohen procedurat ligjore.

z. Reshat Mujota; Unë e di mirë se çka është shpronësimi, e thash edhe më parë, sepse jamë provuar edhe vetë, unë nuk e luaj asnjë rol, mirëpo propozimi im është për me u shty kjo pikë, ajo që po them është se te ato prona që do të shpronësohen mund të kemi edhe pjesë të pronave që mund të jenë të pa shfrytëzuara nga pronarët, ju i keni numrat dhe mund ta votoni.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; E vlerësoi kontributin e juaj për këtë pikë, por mendoj se edhe Kryetari, ka dhënë sqarime të mjaftueshme, prandaj unë do ta hedhi në votim propozimin që ka ardhur nga ekzekutivi. Fillimisht Konstatoi Kuorimin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 9 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pronat e paluajtshme në ZK-Shtime dhe ZK-Petroviq, për Projektin "Unaza e vogël e qytetit".**

Pika 9

Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-56 për rizgjedhjen e Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport, sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-4-2022, dt.13.04.2022

Pika 10

Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-57 për rizgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-3-2022, dt. 13.04.2022

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Fillimisht po sqaroj se kemi pas takim pune me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe jemi dakorduar që të kemi edhe tri Komitete jo obligative:

1. Komiteti për Arsim, Kulturë, rini dhe Sport,
2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
3. Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm.

Pastaj poashtu jemi pajtuar që të diskutojmë për pikat 9 dhe 10 përnjëher dhe të votojmë në pako.

z. Rexhep Gashi; Ju keni vendosë që ti formoni 3 Komitete, por unë mendoj se këtu nuk ka asnjë dobi përveq përfitimeve materiale për anëtarët e këtyre Komiteteve.

z. Reshat Mujota; Kolega që foli paraprakisht më heret ka qenë në dy Komitete, e tash po ederon herë në njërin e her në tjetrin subjekt. Unë nuk jamë për me i votu në pako. Këto nuk janë Komitete obligative kështu që unë personalisht nuk jamë për me i formuar, e ju tregoni nëse e keni sa për me i marrë qato 50 euro. Ju lutem ndalni pazaret se kemi kërkuar ndryshim. Unë kërkoj që jo me u formu Komitete të reja por me i shujtë të gjitha Komitetet jo obligative, sepse këto veq sa e dëmtojnë Buxhetin e Komunës. Nëse i bëni këto Komitete pa pagesë do ta shihni se kush ju vjen në mbledhje.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Unë e thash se jemi pajtuar së bashku me grupet parlamentare. Pajtohem me ju se duhet ta ruajmë Buxhetin. Udhëzimi Administrativ thotë se mund ti themelojmë, meqenëse Buxheti është i ndarë për këtë vit. Kemi pas mendime dhe propozime që edhe sektorin e Kuvendit ta shtojmë, sepse unë mendoj se kjo nuk është shpenzim por investim.

z.Perparim Ramusa; Qështjen e pagesës e specifikon Ligji. U zgjat shumë qështja e themelimit të këtyre Komiteteve, ne u dakorduam paraprakisht që ti themelojmë tri Komitete. Propozoj që të shkojmë me procedurën e themelimit, ti formojmë trupat dhe besoj se duhet ta bëjmë në mënyrën unanime.

z.Besnik Seferi; Pajtohem që kjo çështje është zgjatur shumë. Unë mendoj pikërisht sikurse Reshati. Unë jam i mendimit që fillimisht ti aprovojmë si Komitete, e pastaj të flasim për emrat.

z.Reshat Mujota; Ka Komuna që Komitetet jo obligative nuk i paguajnë. Publikisht deklarojem se nuk i dua 50 euro të Komitetit, sepse e di kontributin e tyre. Le të dihet se janë tu e hapë edhe një Komitet vetëm sa për me i marrë 50 euro.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Tri Komitetet do ti votojmë në pako, dhe në vazhdim do ti lexojmë emrat e tyre.

***Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi Vendimin për formimin e tri komiteteve:**

1.Komiteti për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport, në përbërje: Asllan Beqaj, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Rexhep Gashi dhe Arbenita Brahimi.

2.Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëpunie Sociale, në përbërje: Besartë Musliu-Spahija, Hasan Avdyli, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota dhe Arbresha Syla.

3.Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, në përbërje: Adem Ramadani, Rrahman Jakupi, Muhamet Ademaj, Fetah Dugolli dhe Nexhat Neziraj.

Pika 11

Propozim-Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet 2021-2026, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Kurë është puna te paraja, e sheh pra se si bëhen të gjithë bashkë, krejt njejt si në të kaluarën po veproni.

z.Hamëz Tërshani; Unë po e falënderoj Organizatën ndërkombëtare CDF-në për projektin. Këta kanë bërë edhe punë të tjera me interes për komunën dhe qytetarët e komunës tonë. Një pyetje për drejtorin, dëgjimin publik nuk e kamë parë se kurë është bërë, pastaj si ka qenë pjesmarrja e qytetarëve, dhe cila formë është përkrahë për inkurajimin e qytetarëve?

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshëndetje, faleminderit për pyetjen, realisht ne i kemi kryer procedurat e kërkuara ligjore, e kemi bërë shpalljen në Ueb-faqe, dhe i kemi njoftuar se materialin mund ta marrin te ne kur të duan. Është për keqardhje që pjesmarrës të interesuar nuk ka pas, ku arsyet mund të jenë të ndryshme.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 15 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, Planin Lokal të Veprimit për Biodiversitet 2021-2026, në Komunën e Shtimes.**

Pika 12

Informatë nga Sektori i Bujqësisë për mbjelljet Pranverore

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E njoftoi, Kuvendin se drejtori gjindet në spital për shkak e se e ka thyer këmbën. Kështu që materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë, e hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Perparim Ramusa; Drejtorit i urojmë shërim të shpejtë, por drejtori ka qenë dashur që me e deleguar këtë detyrë te ndonjë zyrtarë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ashtu edhe unë e kisha një informatë se do ta prezantojë këtë pikë Bashklim Ahmeti, por që nuk e di pse nuk ka ardhur. Meqenëse diskutime tjera nuk ka po e mbylli këtë pikë dhe kalojmë te pika e radhës.

Pika 13

Informatë e përgjithshme nga DKRS-ë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Albane Fazliut për prezantimin e kësaj pike.

znj.Albane Fazliu, drejtoresh e DKRS; Përshëndetje, në vazhdim lexoi Informatën të cilën tha se e keni marrë, me kohë (shih dokumentin) Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për Informatën, mirë që i paske përmirësuar disa gabime teknike në tekstin e Informatës.

znj.Albane Fazliu, drejtoresh e DKRS; Po është e vertetë që ka pas disa gabime teknike por i kemi përmirësuar.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit për Informatën, por unë nuk pashë aty ndonjë informacion për qendrën Rinore. Pyetje për drejtoreshën se si e shihni ju infrastrukturën sportive në komunën e Shtimes?

znj.Albane Fazliu, drejtoresh e DKRS; Faleminderit për pyetjen, por sa i përket Qendrës Rinore, tash së shpejti e kemi një projekt të ri për ta realizuar.

z.Besnik Seferi; Faleminderit për Informatën, Pyetje për drejtoreshën, a mund të na informoni për sa i përket ndarjes së subvencioneve për sport? Te klubi i futbollit i uroj për meritat dhe suksesin e tyre por sa është ndarë subvencione për ta? Meqenëse të hyrat janë rritur për 20% unë ju kisha preferuar që këto të hyra ti vëni në përdorim edhe për sport.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për Informatën, dihet që kjo drejtori ka buxhet të vogël, përkundër kësaj unë mendoj se duhet që të rinjëti ti orientojmë kah sporti e jo ata të shkojnë në kafe të ndryshme.

znj.Albana Podvorica; A mendoni ju, që është e mjaftueshme që vetëm një rretht me shkru për aktivitetet në sektorin e rinisë?

znj.Albane Fazliu, drejtoresh e DKRS; Jo nuk mjafton.

Pika 14 (Shtesë)

Shqyrtimi i Kërkesave Npi-01/113

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi Rekomandimet e KPF-së për Kërkesat nën numrin 1 deri në 7 pastaj Kërkesa nr.10, 11, dhe 16, si vijon: Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, të miratoi Konkluzionin për shtyrjen e shqyrtimit të Kërkesave 1 deri 7, 10, 11, dhe 16, me arsyetimin që, të analizohen më mire, të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi, dhe të formohen Komisionet përkatëse për trajtimin e këtyre Kërkesave për emërtimin e objekteve publike.

z.Përparim Ramusa; Lidhur me këto kërkesa që i kemi trajtuar në KPF-ë unë pajtohem që të shtyhen sipas rekomandimit të KPF-së. Po ashtu edhe te kërkesat që kanë të bëjnë me emërtimin e rrugëve dhe emërtimin e objekteve publike që të shtyhen deri sa të themelohen Komisionet për shqyrtimin e tyre.

z.Besnik Seferi; Pajtohem me propozimin e Përparimit, që të themelohen Komisionet paraprakisht.

z.Reshat Mujota; Mandatin e kaluar kemi qenë 5 anëtarë të Komisionit, në mesin e të cilëve kemi qenë edhe unë dhe Besniku, edhe LDK-ja ka qenë me anëtarin e vetë. Ne kemi pas përgatitur një informatë, por kemi pas hy në fushatën zgjedhore kështu që edhe pozitë edhe opozitë kanë qenë për me u shty. Unë mendoj se informata që kemi përgatitur ne është një përparësi për Komisionin e ri që do të formohet. Ka pas propozime të ndryshme, ka pas edhe propozime nga Shoqatat e dala nga Lufta. Du të sqaroj se nëse unë propozohem prap që të jem anëtarë i këtij Komisioni, unë nuk do ta pranoj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Informatën e juaj si Komision i mandatit të kaluar ju mund ta dërgoni në Sekretarinë e Kuvendit, mendoj se do të shërbej për punën e Komisionit të ri, duke bërë një analizë më të mirë për këtë çështje.

z.Përparim Ramusa; Komisioni i mandatit të kaluar ka punuar për këtë çështje, tani meqenëse ka përfunduar mandati i tyre, unë i propozoj, Reshatit dhe Besnikut që informatën ta dorëzojnë te Komisioni i ri.

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se komplet materialin e punës duhet ta dorëzojmë te Komisioni i ri.

z.Adem Ramadani; Sa i përket kërkesave, unë po shoh te kërkesa nr.2 ku është propozuar që Shtëpia e Kulturës, të emërtohet me emrin "Dëshmorët e Raçakut", meqenëse unë mendoj se dëshmorët nuk i takojnë vetëm Raçakut, unë propozoj që të ndryshohet propozimi dhe të jetë "15 Janari". Propozimi im është por edhe me kërkesën e Kuvendit që të ndryshohet kërkesa dhe të riformulohet në vend të emrit të propozuar "Dëshmorët e Raçakut" të bëhet "15 Janari".

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se Komisioni i mëparshëm ka bërë një punë të jashtëzakonshme, sepse emrat e propozuar për Kuvend janë emëra të përgjithshëm e jo emëra të përvetshëm.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Unë po ndërlihem pak me diskutimin mu për shkak të rëndësisë së madhe që ka kjo çështje. Mendoj se kjo çështje është dashur me u kry, sepse ka kaluar një kohë e gjatë, janë marrë në Kuvend shumë Konkluzione për shtyrje, si ka shkuar dhe për far arsye nuk e di por tani po na bjen neve barra. Unë kamë me u munduar që me i marrë parasysh të gjitha kërkesat e qytetarëve, dhe kamë me ardhë në Kuvend me një propozim për formimin e një Komisioni gjithëpërfshirës, duke përfshirë Kuvendin, Ekzekutivin, Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, OJQ-të, etj. dhe pastaj ky Komision do të analizojë të gjitha kërkesat, dhe do të organizojë dëgjim publik me qytetarët, me qëllim që të kemi një vendim meritore, me figura të spikatura të Komunës tonë. Unë propozoj që në kohë të përshtatshme ta themelojmë një Komision për analizën dhe vlerësimin e propozimeve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që Kërkesat nën numrin 1 deri në 7 pastaj Kërkesa nr.10, 11, dhe 16, ti shtyej për shqyrtim, deri në formimin e Komisionit për trajtimin e këtyre Kërkesave për emërtimin e objekteve publike.**

8. Kërkesa e z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z.Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr."Hamëz Jashari" p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-19162/20 datë:24.09.2020,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, kërkesën dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që kërkesa Nr.01-70/05-19162/20 e datës: 24.09.2020 të Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, të shtyhet për shqyrtim për të (2) dytën herë me arsyetimin që: 1. Të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi, 2. Kërkesa të kompletohet me informacione të sakta.**

9. Kërkesa e z.Bekim Osmani – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-19428/20 datë:29.09.2020,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, kërkesën dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

z.Adem Ramadani; E falënderoj z.Osmanin që ka shprehë gatishmëri që ta lëshojë atë pronë si zonë e luftës. Unë propozoj që në mbledhjen tjetër Bekim Osmani, ti sjellë letrat në Kuvend se sa pronë duhet të shpronësohet. Kështu që unë propozoj që ta aprovojmë kërkesën e Bekim Osmanit.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që kërkesa Nr.01-70/05-19428/20 e datës: 29.09.2020 të Bekim Osmanit nga fshati Raçak, të shtyhet për shqyrtim, për të (2) dytën herë me arsyetimin që të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi.**

12. Kërkesa e znj.Zhaneta Demiri – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-6353/22 datë:07.03.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, kërkesën dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që kërkesa, Nr.01-070/05-6353/22 datë:07.03.2022, e Zhaneta Demirit nga Shtimja, të Transferohet në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, dhe drejtorisë i Rekomandon që brenda mundësive ta ndihmoi financiarisht.**

13. Kërkesa e z.Ikrem Bajrami – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-1076/22 datë: 21.04.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, kërkesën dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që kërkesa, Nr.01-070/05-1076/22 datë: 21.04.2022, e Ikrem Bajramit nga fshati Raçak, të transferohet në Drejtorinë për Shërbime Publike, për shqyrtimin e sajë.**

14. Kërkesa e z.Avni Dugolli – Pjetërshticë, Kërkesa Nr.01-070/05-10327/22 datë: 22.04.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, kërkesën dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj.Adelina Beqaj; Le të mbetet si praktikë në të ardhmen, që drejtoritë të japin rekomandimet e tyre, dhe mos të shtyhen kërkesat.

z.Rexhep Gashi; Te kjo kërkesë ai ka kërkuar që të zgjerohet ajo parcelë për varrezat, i ka dorëzuar të gjitha dokumentacionet të kompletuara. Pse drejtoria nuk ka ardhur me një rekomandim?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Në rastin në fjalë janë dy palë varreza, fillimisht ne por edhe Kuvendi duhet ta ketë të qartë mirë se për qka po bëhet fjalë aty, ne do të jemi në kordinim me banorët aty dhe po ashtu do ta japim një rekomandim për Kuvendin, mirëpo sigurisht që donë pak më shumë analizë.

z.Lumni Amrushi; Unë kam raporte të mira me parashtruesin e kërkesës, ai e ka kompletuar kërkesën, e di fare mirë terrenin, dhe ata janë duke punuar për me e rrafshuar terrenin aty. Lokacioni ku ka bërë kërkesë Avnija aty janë të varrosur disa familjarë të tyre. Mendoj se nuk është urgjente dhe është më mirë që të konsultohen edhe banorët, dhe të marrim pastaj vendim të drejtë.

z.Muhamet Ademaj; Edhe unë jam që mos të ngutemi e të bëjmë gabime si në të kaluarën e pastaj të na përsëriten dhe të na kthehen nga Ministria. Ti kemi të gjitha faketet përpara dhe të marrim vendim të drejtë.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që kërkesa Nr.01-070/05-10327/22 datë: 22.04.2022, e Avni Dugollit nga fshati Pjetërshticë, të shtyhet për shqyrtim, me arsyetimin që të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi.**

15. Ankesa e z.Gani Ademaj – Petrovë, Ankesë Nr.01-070/05-10354/22 datë: 22.04.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, kërkesën dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

z.Muhamet Ademaj; Unë e kam kusheri parashtruesin e ankesës, ai tash më është 70 vjeçar dhe dikush e ka manipuluar për me bërë një ankesë të tillë. Sa i përket lokacionit për Çerdhe ne jemi duke diskutuar që ta gjejmë një lokacion sa më të përshtatshëm, dhe nuk është e vërtetë që ne kemi vendosur aty, ai ka qenë vetëm një propozim, të gjithë banorët do të kanë mundësinë që të japin kontributin e tyre për caktimin e këtijë lokacioni.

z.Reshat Mujota; Unë jam që kjo ankesë të refuzohet, por nuk pajtohem me parafolsin se është i manipuluar një 70 vjeçar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 18 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi që të refuzohet ankesa, Nr.01-070/05-10354/22 datë: 22.04.2022, e z.Gani Ademaj nga fshati Petrovë, me arsyetimin se lokacioni për Çerdhe në fshatin Petrovë nuk është vendosur ende, më konkretisht në fshatin Petrovë është në proces e sipër diskutimi publik për sa i përket caktimit të Lokacionit për Çerdhe, ku mund të kontribuoni edhe ju së bashku me bashkëfshatarët e juaj.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mblëdhjen e përfundoj në ora 13:44h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi